

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe I

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 101	B	1	4	0	0	4.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Brikena Smajli, PhD				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.				
Objektivat			<ul style="list-style-type: none"> •Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. •Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. •Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjërimin normativ. •Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). •Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde. 				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Gjuha shqipe gjatë zhvillimit të saj historik çështjet kryesore - Shqiptarët dhe gjuha e tyre; - Tiparet e gjuhës - Funkzionet e gjuhës - Gjuhësia dhe zhvillimi i mendimit gjuhësor
2	Gjuha shqipe si gjuhë indoevropiane çështjet kryesore - Familja gjuhësore indoevropiane; - Identiteti indoevropian i gjuhës shqipe; - Gjuha shqipe si bijë e vetme; - Shkrimi i gjuhës shqipe;
3	Gjuha standarde (letrare) shqipe dhe dialektet çështjet kryesore - Gjuha standard shqipe; - Dialektet, nëndialektet dhe të folmet; - Vijueshmëria e përplotësimit të gjuhës standard shqipe;
4	-Fonetika çështjet kryesore - Tiparet e tingujve të gjuhës; - Aparati fonetik te njeriu; - Zanoret dhe bashkëtingëlloret;
5	Theksat në gjuhën shqipe çështjet kryesore - Njësitë fonetike; - Veëoritë e theksit; - Theksi logjik dhe emocionues; - Intonacioni;
6	Leksikologjia çështjet kryesore - Objekti i studimit të leksikologjisë; - Shenja gjuhësore; - Tiparet dhe vlerat e fjalës shqipe;
7	Analiza semantike çështjet kryesore - Kuptimi leksikor; - Lëvizjet kuptimore dhe figurat gjuhësore; - Tipat e kuptimeve leksikore; - Struktura kuptimore e fjalës; - Ngjyrimi emocionues si pjesë e përmbajtjes kuptimore të fjalës;
8	Provim gjysmëfinal (MIDTERM). Analiza semantike çështjet kryesore - Kuptimi leksikor; Ushtrime
9	Lidhjet kuptimore të fjalëve çështjet kryesore - Sinonimet; - Antonimet; - Homonimet;
10	Frazeologjia çështjet kryesore - Frazeologjia; - Njësitë frazeologjike; - Klasifikimi i njësive frazeologjike; - Kalket dhe huazimet frazeologjike
11	Leksiku i gjuhës shqipe çështjet kryesore - Zhvillimi i leksikut; - Shtresimi kohësor i leksikut; - Shtresimi i leksikut sipas përdorimit;
12	Leksikografia dhe fjalorët e gjuhës shqipe çështjet kryesore - Leksikografia dhe fjalorët; - Historiku i leksikografisë shqiptare; - Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (1980);
13	Stilet funksionale të gjuhës shqipe çështjet kryesore
14	- Kuptimi për stilin gjuhësor; - Mjetet dhe norma stilistikore; - Veçëoritë e stileve funksionale të gjuhës shqipe;

15	- Kuptimi për stilin, Ushtrime		
16	Provim Final		
Parakushtet			
Literatura		<ul style="list-style-type: none"> • Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës). • Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002. • Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFa, 2004. 	
Referenca të tjera		<ul style="list-style-type: none"> • Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006. • Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999 • Robert Elsie, Historia e Letërsisë shqiptare. • Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276. 	
Punë laborator			
Përdorimi i komp.			
Të tjera			
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.		
2	Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.		
3	Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	20
Kuize		2	10
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	14	14

Të tjera	1	5	5
Ngarkesa totale e orëve			135
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5,4
ECTS			5